



# STATUTI

## I KONFEDERATËS SË SINDIKATAVE TË SHQIPËRISË

- I miratuar në kongresin e 5-të të KSSH-së, datë 30 Nëntor 2014 -

### KREU I PARË

#### Neni 1

#### EMRI I ORGANIZATËS

Emri i organizatës sindikale është: Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë ( iniciale KSSH)  
KSSH është krijuar dhe funksionon si organizatë sindikale konfederative në përputhje me ligjin shqiptar dhe standartet më të larta europiane dhe ndërkombëtare.

KSSH është e njohur si Person Juridik me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr.6/1, datë 3.09.1991. Mbledhja e saj themeluese është zhvilluar më 5 Qershor 1991.

KSSH ndodhet me seli qendrore në adresën: Sheshi "Garibaldi" nr.3, Njësia Bashkiake nr.6, kodi postar 1027, Kombinat, Tiranë.

#### Neni 2

KSSH përfaqëson ruajtjen e interesave shoqërore, ekonomike e sociale të anëtarëve të saj dhe të cdo qytetari në përgjithsi, si individualisht ashtu edhe në menyre kolektive, me qëllim arritjen e standardeve optimale të punës, mirëqënies sociale dhe më gjërë në cdo sferë të jetesës.

Si një bashkësi sindikale konfederative, KSSH ka si qëllim fuqizimin e lëvizjes sindikale në Shqipëri, për mbrojtjen e të drejtave, dinjitetit dhe interesave ekonomike e sociale të anëtarëve të saj dhe cdo punëmarrësi, nëpërmjet veprimit dhe aksionit sindikal.

#### Neni 3

#### PARIME TË PËGJITHSHME

KSSH është organizatë sindikale demokratike, e pavarur nga shteti, partitë politike, grupimet fetare, punëdhënësit publik apo privat dhe nga organizatat e ndryshme jofitimprurëse.

KSSH, në të gjithë veprimtarinë dhe punën e saj udhëhiqet nga vullneti i lirë i anëtarësisë së saj të shprehur nëpërmjet organeve statutore vendimarrëse të saj të cilët janë Kongresi, Asambleja e

Përgjithëshme, Presidenca Ekzekutive, Presidenti dhe organet e KSSH-së në nivel territorial vendor.

Federatat Sindikale dhe Sindikatat nuk janë organe vendimmarrëse të KSSH-së, vendimet e tyre, respektojnë detyrimet e përcaktuara në këtë statut por nuk prekin dhe nuk çenojnë në asnjë rast dhe asnjë mënyrë KSSH-në, përveç kur organet statutore të KSSH të përmendura më sipër, marrin përsipër nëpërmjet një vendimarrje të drejtpërdrejtë, të shprehur dhe të dokumentuar. Megjithatë, Statuti i çdo Federate apo Sindikate Profesioni, që është pjesë e KSSH-së, duhet të jetë i unifikuar me këtë Statut duke u konvaliduar paraprakisht nga Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së.

KSSH, veprimtarinë e saj e bazon në këtë Statut, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventat Ndërkombëtare të ILO-s, Direktivat e BE-së, Parimet Universale për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, në strategjinë dhe objektivat e sindikalizmit evropian dhe botëror, pjesë e të cilës ajo është.

KSSH, zbaton me rigorozitet standardet dhe normat demokratike në ndërtimin dhe funksionimin e strukturave të saj dhe në zgjedhjen e organeve drejtuese. Në forumet drejtuese dhe strukturat e KSSH-se, inkurajohet dhe mbështetet debati i hapur, respektohet mendimi ndryshe dhe vendimet merren në mënyrë demokratike.

Organet e zgjedhura të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë në të gjithë strukturat e saj drejtuese nga qendra në bazë funksionojnë sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut. Organet drejtuese zgjidhen në mënyrë demokratike nga poshtë lartë, japin llogari para zgjedhësve dhe janë të revokueshme përpara tyre në cdo kohë, përveç kur në këtë statut parashikohet shprehimisht ndryshe.

#### **Neni 4**

### **QËLLIMI I ORGANIZATËS**

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë ka për qëllim dhe mision kryesor të saj të hartojë, të udhëheqë, të organizoj dhe të mbrojë politikat e lëvizjes sindikale në vend, posaçërisht në fushën e marrëdhënieve të punës, të pagave, të pensioneve, mbrojtjen nga largimi i padrejtë nga puna, përmirësimin të vazhdueshëm të kushteve të punës dhe të jetesës, sigurisë në punë, përfshirë kërkesat dhe nevojat sociale, ekonomike dhe kulturore të sindikalistëve dhe punonjësve, të papunëve, pensionistëve, grave, të rinjve, invalidëve, etj.

Në përputhje me këtë mision KSSH ndërton marrëdhëniet me partnerët ligjor e social, me pushtetin legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor, shoqërinë civile, punëdhënësit dhe cdo organizatë dhe partner tjetër.

Për përmbushjen e misionit dhe të qëllimit kryesor të saj, KSSH synon dhe angazhohet posaçërisht:

- Të garantojë punë të denjë për cdo të punësuar në Republikën e Shqipërisë
- Të sigurojë solidaritet dhe asistencë për sindikatat e profesioneve dhe ato rajonale e vendore dhe për cdo anëtar apo sindikalist pjesë të saj.

- Të siguroj punësim të plotë dhe të zgjedhur lirisht, prosperitet dhe standartizim më të mirë të jetesës për të gjithë anëtarët e saj, përfshirë sigurimin e pagave dhe të pensioneve, rregullimin e kohës së punës, sigurinë dhe shëndetin në punë, ulje të kohës së punës si dhe përmbushje të nevojave materiale e shpirtërore të punëmarrësit, Sigurimi i një mbrojtjeje ligjore efektive duke garantuar përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të punëmarrësve në çdo organ administrativ dhe gjyqësor, ngritje të nivelit arsimor dhe kualifikimit profesional, zbatimi rigoroz i rregullave të sigurimit teknik në punë, sigurimin e kontraktimit kolektiv dhe një mbrojtje kolektive efektive ndaj punëdhënësit duke garantuar negociim e zhvillim dialogu dy e tri palësh në të gjitha nivelet. Përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, etj.
- Të garantojë integrimin e plotë të grave në organizatat sindikale dhe të promovojë në mënyrë aktive barazinë gjinore në strukturat e saj vendimmarrëse në të gjitha nivelet.
- Të mbështesë të drejtat e punëtorëve të rinj për punë të përshtatshme, edukim dhe trajnim, pjesëmarrjen e tyre të plotë në të gjitha nivelet vendimmarrëse.
- Të garantojmë mbrojtje dhe mbështetje për të drejtat e punonjësve migrantë dhe emigrantë.
- Të forcojë solidaritetin ndërmjet brezave brenda levizjes sindikale dhe të mbështesë të drejtat e punonjësve në pension për të ardhura të mjaftueshme.
- Të kontribuojë për eliminimin e punës së detyruar si dhe të punës së femijëve dhe të asaj informale.
- Të luftojë perjashtimet sociale dhe nëpërmjet nxitjes së aksesit universal për kujdes shëndetësor të përshtatshëm dhe arsim bazë të detyrueshëm, për të siguruar cilësi në shërbimet publike dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Të ruajë dhe të zhvillojë bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me organizatat e tjera kombëtare apo vendore si me ato qeveritare, joqeveritare, shoqërinë civile, etj; për të zhvilluar më tej politikën dhe aktivitetet e Konfederatës në avancimin e interesave të shoqërisë si një e tërë.
- Të sigurojë një legjislacion për marrëdhëniet e punës demokratik dhe bashkëkohor duke ruajtur me fanatizëm interesin madhor të punëmarrësit që ajo përfaqëson.
- Të mbrojë sindikalitetin nga veprimet burokratike dhe arbitrare të punëdhënësve shtetërore ose privat.
- Të ruaj dhe zhvillojë një organizatë Sindikale Kombëtare të fuqishme, të bashkuar, pluraliste, përfaqësuese dhe demokratike, të përberë nga Organizata Sindikale Profesionale të lira dhe demokratike, të afta për të ngritur dinjitetin e punës së denjë duke promovuar dhe mbrojtur në mënyrë efektive të drejtat dhe interesat e punëmarrësve në nivel kombëtar dhe rajonal.
- Të forcojë solidaritetin ndërkombëtar me sindikatat dhe punonjësit e vendeve të ndryshme të europës dhe gjithë botës.

## **Neni 5**

Për arritjen e këtyre qëllimeve KSSH përdor mjetet ligjore demokratike që ka në dispozicion dhe që janë:

- Negocimet, ndërmjetësimet, lobimet, dialogu social, përfaqësimi administrativ dhe gjyqësor si dhe aksioni sindikal.

- Organizimi i takimeve, bisedave, mbledhjeve, mitingjeve, manifestimeve, protestave dhe demonstratave.
- Aksioni sindikal, përfshirë grevën e pjesshme ose të përgjithshme.
- Manifestimet e solidaritetit për probleme jetike të vendit dhe kombit, për ruajtjen e lirisë dhe pavarësisë, për denoncimin e veprimtarive antidemokratike e antipunëtore.
- Përdorimin e të drejtës së rezistencës demokratike
- Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të punonjësve (individualisht dhe kolektivisht) përpara cdo organi legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.
- Në rastet kur e vlerëson të domosdoshme, nënshkruan marrëveshje apo kontrata kolektive në nivel kombëtar dhe marrëveshje ose kontrata kolektive në nivel vendor nëpërmjet strukturave të saj statutore vendore.
- Përdorimin e cdo mjeti tjetër demokratik dhe të ligjshëm në funksion të aktivitetit të saj.
- KSSH punon për demokratizimin e lëvizjes sindikale në vend, për sigurimin e një fryme të plotë pluraliste e demokratike në veprimtarinë e sindikatave në të gjithë nivelet.
- KSSH zhvillon e forcon lidhjet me sindikatat e vendeve të ndryshme dhe institucionet e organizmat sindikale ndërkombetare mbi bazën e parimit të solidaritetit dhe të interesit reciprok.
- KSSH është anëtare e Konfederatës Ndërkombëtare të Sindikatave (ITUC), Konfederatës Europiane të Sindikatave, (ETUC), Këshillit Sindikal Rajonal Ndër European (PERC), Konfederatës Europiane të Sindikatave të Pavarura (CESI), dhe organizata të tjera sindikaliste demokratike, rajonale apo ndërkombëtare që mund të krijohen në të ardhmen.

## **Neni 6**

### **ANËTARËSIA SINDIKALE**

Anëtarësia e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë përbëhet nga anëtarësia e regjistruar në organizatat bazë sindikale, në ndermarrje, sektorë, institucione, njesi administrative, etj. të cilët janë depozituar në departamentin e Organizimit të KSSH tre mujorin e parë të cdo viti dhe të miratuar sipas përcaktimeve të këtij statuti.

Në këto organizatat sindikale mund të anëtarësohet çdo i punësuar në sektorin publik ose privat, punonjës që janë në asistencë ose përkoheishtë të papunë, emigrantët si dhe pensionistët, sipas profesioneve të tyre në federatat/rrjetet përkatëse apo sindikatat qëndrore të profesionit. Antarësimi në organizatat sindikale të KSSH-së është vullnetar.

Sapo pranohet çdo anëtar sindikate pajiset me kartën e antarësisë e cila përmban shenjën dalluese të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë dhe të Federatës përkatëse, identitetin e numrin personal të anëtarit, emrin dhe selinë e organizatës që e lëshon.

Anëtari që largohet nga sindikata është i detyruar të kthejë kartën e antarësisë. Kur kjo kartë humbet duhet të njoftohet autoriteti lëshues i saj dhe departamenti i organizimit i KSSH-së të cilët e shpallin të pavlefshme atë.

Në rast largimi me dëshirë si dhe ripranimi në ndonjë sindikatë tjetër anëtari që largohet duhet t'i shlyejë sindikatës detyrimet (statutore) financiare deri në perfundim të vitit kalendarik.

## **KREU I DYTË**

## **STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE FORUMET E KSSH-së**

### **Neni 7**

#### **KONGRESI I KSSH-së**

Organi më i lartë vendimmarrës i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë është Kongresi i saj. Ai analizon gjithë veprimtarinë e KSSH-së gjatë periudhës ndërmjet dy Kongreseve.

Kongresi përcakton programin dhe politikën e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë për të ardhmen. Norma e përfaqësimit, rendi i ditës dhe cdo aktivitet tjetër që ka lidhje me kongresin përgatitet nga Presidenca Ekzekutive dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-së.

Kongresi mbledhet në sesione të zakonshme një herë në pesë vjet. Kongresi i fillon dhe i zhvillon punimet kur janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e delegatëve.

Me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të Asamblesë së KSSH-së, thirret Kongresi i Jashtëzakonshëm i KSSH-së.

Kongresi ka atributet e Kongresit të zakonshëm vetëm atëhere kur vendos Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-së me 2/3 e votave.

Ne rastet kur Kongresi thirret nga 2/3 e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithëshme të KSSH-së, keta të fundit, i dorezojnë kërkesën me shkrim Presidentit të KSSH-së, i cili ja bën atë të njohur Asamblesë së Përgjithëshme të KSSH-së. Kërkesa duhet të ketë të argumentuar çështjen/çështjet/arsyet e argumentuara, për të cilat kërkohet zhvillimi i Kongresit si dhe emrat dhe nënshkrimet e kërkuesve të noterizuara. Kongresi zhvillohet jo më vonë se 30 ditë nga data e miratimit (të shprehur në një vendim) të kësaj kërkesë, nga Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-së. Ky vendim si dhe rendi i punimeve të kongresit, kur thirren nga 2/3 e anëtarëve të Asamblesë, duhet të miratohet me jo më pak se 2/3 e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithëshme të KSSH-së.

Kongresi i KSSH-së, zgjedh Presidentin e KSSH-së, në përputhje me Rregulloren që vendos Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-së, për zhvillimin e Kongresit. Miraton strukturën e Asamblesë së Përgjithëshme të KSSH-së, strukturën e Komisionit të Financës dhe të Auditit, strukturën e Komisionit të Gjyimit Disiplinor dhe Statutit si dhe proklamon politikën, programin dhe synimet e KSSH-së për pesë vitet në vazhdim.

Emrat e secilit anëtar të strukturave të mësipërme (komisioni i financës dhe auditit, komisioni i gjyimit disiplinor dhe statutit) në mënyrë nominale caktohen në mbledhjen e parë të Asamblesë së përgjithëshme të KSSH-së që zhvillohet pas ligjërimit të kongresit.

Vendimet dhe Rezolutat e Kongresit merren me shumicën e cilësuar të votave të delegatëve pjesëmarrës, me përjashtim të rasteve kur Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-së, e përcakton ndryshe.

### **Neni 8**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E KSSH-së**

Asambleja e Përgjithshme e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) është organi më i lartë vendimmarrës në perjudhën midis Kongreseve të KSSH-së dhe institucioni kryesor përgjegjës për organizimin, bashkërendimin dhe drejtimin e punës së Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë(KSSH) në zbatim të vendimeve dhe orjentimeve të kongresit, këtij statuti dhe vendimeve të organeve statutove vendimmarrëse të KSSH-së.

Vendimet e saj janë detyrimisht të zbatueshme nga të gjitha strukturat organizative dhe ndihmëse të KSSH, nga qendra deri në bazë (organizata sindikale, këshilla asamble sindikale në bashki, rreth, qark, sindikata qendrore profesioni, federatash, dhe cdo strukture tjetër) si dhe prej cdo anëtari të saj.

Struktura e Asamblesë së Përgjithshme, si rregull, vendoset nga kongresi i KSSH-së. Asambleja e Përgjithshme e KSSH, në mbledhjen e saj të parë, konstituon dhe miraton nominalisht(emër për emër), Asamblenë e Përgjithshme të KSSH. Mbledhja e parë bëhet brenda 45 ditëve nga dita e depozitimit të Kongresit.

Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, në mbledhjen e saj të parë pas Kongresit të Zakonshëm dhe pas konstituimit, me propozim të Presidentit të KSSH-së, zgjedh dy Zv/presidentë ku të paktën 1 (një) të jetë grua, nga radhet e Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së.

Zv presidentet në përputhje me këtë Statut dhe me Rregulloren dhe Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së, kryejnë detyrat e tyre funksionale në mbështetje të Presidencës Ekzekutive dhe në përputhje me detyrat që iu ngarkohen me rregullore apo me një akt të veçantë nga Asambleja e Përgjithshme, Presidenca Ekzekutive ose Presidenti i KSSH-së.

## **Neni 9**

### **DETYRAT KRYESORE TË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË KSSH-së**

Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, ka këto detyra kryesore:

- Të organizojë dhe drejtojë veprimtarinë sindikale nëpërmjet përpunimit dhe zbatimit të politikave sindikale në nivel kombëtar.
- Të koordinojë veprimtarinë midis Federatave, Sindikatave Qëndrore, Sekretariateve të njësisive administrative vendore dhe të organizatave sindikale bazë, t'i mbështesë ato për plotësimin e objektivave të tyre.
- Të kontrollojë zbatimin e vendimeve të Kongresit në të gjithë strukturat e KSSH-së.
- Të shpallë e të organizojë lëvizje sindikale kombëtare, përfshirë manifestime, protesta dhe greva të pjesëshme ose të përgjithëshme. Vendimet për këto veprimtari merren me 2/3 e anëtarëve të Asamblesë.
- Zgjedh komisionet dhe strukturat apo drejtuesit përkates, në përputhje me statutin e KSSH – së dhe ushtron të drejtat që i janë dhënë në cdo rast tjetër.
- Përshtat dhe ndryshon strukturën organizative të KSSH-së
- Bën zëvendësimin e Anëtarëve të Asamblesë të cilët në përputhje me këtë rregullore janë vet larguar ose janë përjashtuar.
- Në cdo kohë, pezullon ose përjashton deri në një vendim tjetër të Asamblesë (në mënyrë të shprehur ose të heshtur), Federatat apo Sindikatat që nuk plotësojnë detyrimet ndaj KSSH-së, ose shkelin rregullat e funksionimit të parashikuara në aktet që rregullojnë veprimtarinë e

KSSH-së. Në rastin e pezullimit, përfaqesuesit që mund të kishte kjo Federatë ose Sindikatë në organet vendimarrëse të KSSH-së, nuk llogariten në Kuorumin për vendimarrje, apo për çfardollosje efektive tjetër në marrëdhëniet me KSSH-në. Pezullimi sjell të gjitha efektet e një përjashtimi të përkohshëm, deri në vendimarrje tjetër.

- Miraton, përpara se të hyjnë në fuqi, rregulloret e Asambleve të KSSH-së në nivel territorial.
- Miraton numrin e delegateve për në kongresin e KSSH-së, verifikon dhe miraton paraprakisht dhe nominalisht cdo delegat, duke parë përputhshmërinë e mandatit të tij me statutin e KSSH-së. Në rast refuzimi të miratimit të delegatit, i kërkon strukturës që përfaqësohet të bëjë zëvendësimet përkatëse, në të kundërt, përvec sanksioneve ndaj strukturës që nuk ka bërë apo ka refuzuar propozimin, urdhëron zëvendësimin e delegatit/ve dhe/ose përjashtimin apo pezullimin e strukturës që nuk ka bërë zëvendësimin. Nuk mund të zëvendësohen në Asamble drejtuesit e Federatave dhe Presidentët e Sindikatave, përvec kur struktura që ata drejtojnë është përjashtuar ose pezulluar.
- Në cdo rast kur e vlerëson të domosdoshme, urdhëron riorganizime ose rithemelime të strukturave të KSSH-së, të reja apo ekzistuese, përfshi Sindikatat dhe Federatat, në përputhje me dinamikën e tregut të punës në Shqipëri sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut.
- Verifikon dhe miraton cdo fillim viti, në shkallë të fundit, numrin e anëtarëve të deklaruar nga strukturat e KSSH, në rrethe, qarqe, sindikata, federata sindikale dhe në cdo strukturë tjetër të KSSH që merret me anëtarësinë në terren. Numri i anëtarëve të konstatuar nga Asambleja e KSSH-së është përfundimtar dhe i pakundërshtueshëm. Numri i antarësisë i konstatuar nga Asambleja llogaritet për cdo marrëdhënie brenda KSSH-së, apo në raportet e KSSH-së me organizata apo institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Me 3/5 e votave, vendos dhe shpall thirrjen e Kongresit të KSSH-së, jo më vonë se 45 ditë nga dita e zhvillimit të Kongresit të KSSH-së. Përcakton rendin e ditës, përcakton normat e përfaqësimit dhe mënyrën e zgjedhjes së delegateve, brenda kritereve që përcaktohen në këtë Statut dhe në Rregulloren e KSSH-së. Asambleja e Përgjithshme raporton para Kongresit për veprimtarinë sindikale për periudhën nga Kongresi i mëparshëm.
- Mblidhet jo më pak se dy herë në vit.
- Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së, drejtohen nga Presidenti i KSSH-së me pjesëmarrjen e 2 (dy) zëvendës Presidentëve.
- Ka cdo kompetencë tjetër të novjoshme për menaxhimin efikas të aktivitetit sindikal të KSSH-së e cila nuk i është dhënë shprehimisht një strukture tjetër statutores të KSSH-së.

## **Neni 10**

### **MBLEDHJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË KSSH-SË**

Mbledhja e Asamblesë së KSSH-së thirret vetëm me kërkesë të Presidentit të KSSH-së ose të jo më pak se 1/2 të anëtarëve të saj.

Presidenti i KSSH-së për probleme të një rëndësie të vecantë thërret mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-se brenda 5 diteve nga data e njoftimit.

Ne rastet kur mbledhja thirret nga ½ e anëtareve të Asamblesë së Përgjithshme, keta të fundit, i dorëzojnë kërkesën me shkrim Presidentit të KSSH-së, i cili ja bën atë të njohur Presidencës Ekzekutive të KSSH-së. Kërkesa duhet të ketë të argumentuar çështjen/çështjet për të cilat kërkohet zhvillimi i mbledhjes si dhe emrat dhe nënshkrimet e kërkuesve të noterizuara. Mbledhja e Asamblesë zhvillohet jo me vonë se 30 ditë nga data e miratimit (të shprehur në një vendim) të kësaj kërkesë, nga Presidenca Ekzekutive e KSSH. Ky vendim si dhe rendi i punimeve të mbledhjes së Asamblesë, kur thirren nga ½ e anëtarëve të Asamblesë, duhet të miratohet me jo më pak se 2/3 e anëtarëve të Presidencës Ekzekutive të KSSH-së.

Procedura e thirrjes së mbledhjeve të Asamblesë parashikuar në këtë nen, zbatohet detyrimisht (për efekt vlefshmërie), si për mbledhjet e zakonshme ashtu edhe për ato të jashtëzakonshme.

Të gjithë projektvendimet, për të cilat duhet të jap votën e vet Asambleja, duhet që më parë të kenë marrë mendimin e Presidencës Ekzekutive të KSSH-së ose ½ e firmave të noteruara të anëtareve të Asamblesë e cila edhe në këtë rast thirret si më sipër.

Punimet e Asamblesë së Përgjithshme, i drejton Presidenti i KSSH, dhe në mungesë të tij, njëri nga dy zv. Presidentët, i autorizuar me shkrim nga Presidenti i KSSH. Në rastin e fundit rendi i ditës miratohet parapakisht nga Presidenti i KSSH.

Kur një anëtar i Asamblesë mungon dy herë pa arsye në mbledhjet e Asamblesë, konsiderohet i vet larguar nga kjo strukturë, pa qënë i nevojshëm ndonjë vendim përjashtimi nga Asambleja. Në këtë rast plotësimi i vendit vakant bëhet me propozim të strukturave përkatëse që përfaqesohen në këtë pozicion. Në rast se kjo strukturë nuk e plotëson vendin vakant brenda një kohe të arsyeshme që vendoset nga Asambleja, atehere vendi vakant plotësohet nga vet Asambleja. Për këtë rast Asambleja mund të marrë edhe mendimin e strukturave të KSSH që mbulojnë sektorin përkatës. Në rastin e fundit Presidenti i KSSH mund të propozojë edhe masa ndëshkuese ndaj strukturës që nuk ka propozuar zëvendësimin.

Në cdo rast, për shkaqe të arsyeshme apo mbarëvajtje të mbledhjes ose aktivitetit sindikal, Asambleja mund të vendos përjashtimin ose zëvendësimin e cdo anetari të Asamblesë në përputhje me këtë statut. Për zëvendësimin e tij/tyre (plotësimin e vendit vakant) vepron si në pikën e mesipërme.

Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, diskuton për raportet mbi veprimtarinë e Presidencës Ekzekutive të KSSH-së, dhe i miraton ato me ndryshimet, plotësimet dhe përmirësimet përkatëse.

Diskuton për materialet, konkluzionet dhe vendimet, të cilat i paraqiten nga Komisioni i Gjyimit Disiplinor dhe Statutit, Komisioni i Financës dhe Auditimit, Qendra e Trajnimit dhe Studimeve Sindikale dhe merr masat përkatëse, sipas propozimeve që i bëhen nga këto organe.

Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së përcakton me rregullore parimet e administrimit të pronave dhe asetëve financiare të KSSH-së.

Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, aprovon Buxhetin Vjetor të KSSH-se dhe bilancin vjetor të veprimtarisë financiare, të cilat i paraqiten për miratim nga Presidenca Ekzekutive duke rakorduar me buxhetet dhe bilancet vjetore të Federatave, Sindikatave Qëndrore, Sekretariateve të njesive administrative me Departamentin Ekonomik të KSSH-së.



Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, miraton Rregulloren e Funkcionimit Organizativ të KSSH-se, dhe rregullat procedurale për funksionimin e Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së, të Presidencës Ekzekutive të KSSH-se, dhe të organizmave të tjerë që mund të krijohen në Konfederatë më vendim të Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së.

Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, vendos për pranimin e Federatave, të Sindikatave Qëndrore në Nivel Profesionit të krijuara përpara momentit që bëhet kërkesa për anëtarësim, të cilat kërkojnë të jenë anëtare të KSSH-së, në përputhje të plotë me këtë statut. Pavarësisht vendimit të Asamblese, kërkuesi mund ti drejtohet kongresit të radhës i cili vendos.

Në rast largimi të vullnetshëm apo përjashtim të një strukture të KSSH, Asambleja e Përgjithshme e KSSH vendos në çdo kohë për riorganizimin e pjesës së mbetur në përputhje me statutin e KSSH-së.

Në rast riorganizimi të çdo strukture të re në nivel sindikate apo federate, në përputhje me dinamikën e zhvillimit të ekonomisë, struktura e re e riorganizuar sipas vendimit të Asamblese së Përgjithshme të KSSH, pasi miratohet në mënyrë të shprehur me vendim të posaçëm nga Asambleja e Përgjithshme e KSSH si në momentin që fillon riorganizimi dhe në momentin që ka përfunduar, konsiderohet anëtare e KSSH me të drejta të plota.

Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, ka të drejtë të kryej çdo lloj riorganizimi në cilindo sektor ekzistues (Federatë, sindikate qendrore profesioni, strukturë rajonale vendore) apo që nuk ekziston deri në atë moment në KSSH dhe në çfarëdo momenti që ajo e vlerëson të nevojshëm. Vendimet e Asamblesë në këtë rast merren me 3/5 e anëtarëve të Asamblesë.

Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, në kuadër të mbarvajtjes dhe rritjes së aktivitetit sindikal, ka kompetencë të plotë statutores të vendos përjashtimin ose riorganizimin e menjëhershëm të çdo Federate apo sindikate anëtare e KSSH-së, në këtë rast vendimi ka efekt të menjëhershëm. Federata apo sindikata e përjashtuar ka të drejtën e apelit në kongresin e radhës i cili mund të vendosë për riantarësim.

Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së, miraton me propozim të Presidencës Ekzekutive Rregulloren Elektorale, përfaqësinë e përgatitjes së Kongresit. Ajo vendos për zgjedhje të pjesëshme në strukturat e KSSH-së, kur bie votëbesimi, apo krijohen struktura të reja. Asambleja e Përgjithshme vendos për aleancat dhe lobingjet politike që mund të krijojë KSSH-ja, në dobi të saj.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të vlefshme kur në to marrin pjesë shumica e anëtarëve. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme janë të zbatueshme kur për to votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme (dhe jo e të pranishmëve në mbledhje). Përjashtim bëjnë shpallja e grevës së pjesëshme ose të përgjithshme dhe propozimi për pranimin ose largimin e Federatave, apo Sindikatave Qëndrore të Profesionit për të cilat duhet të shprehen në favor më shumë se 2/3 e anëtarëve të Asamblesë si dhe çdo rast tjetër i përcaktuar në këtë statut.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me votim ose me konsensus. Vendimet merren pas debatit dhe shkëmbimit të lirë të mendimeve. Vendimet e miratuara me shumicë votash janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë strukturat e KSSH-së, të cilave u referohet vendimi dhe çdo strukturë tjetër e KSSH-së. Pakica që ka votuar kundër, ka të drejtë të shfaqë pikëpamjet e saj në mbledhje si dhe të kërkojë rishqyrtimin e vendimit në strukturat që përcakton Statuti i

KSSH-së. Vendimet te cilat për arsye të përlegjura anulohen brenda afateve, i anulon vetëm Komisioni i Statutit pasi të bëjë përputhshmërinë e interpretimit të vendimit me Statutin apo rregulloret e KSSH-së.

Vendimet e Asamblesë së KSSH mund të kundërshtohen nga pala e interesuar brenda 10 ditëve nga marrja e tyre. Në të kundert janë të pakundershtueshëm për palën e interesuar.

Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë së KSSH-së i zbardhur dhe vendimet e saj firmosen, për efekt vlefshmërie, nga Presidenti i KSSH-së.

## **Neni 11**

### **PRESIDENCA EKZEKUTIVE E KSSH -së**

Presidenca Ekzekutive e KSSH-së, përbëhet sipas përcaktimeve strukturore që bën Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-së. Presidencën Ekzekutive e miraton dhe e zgjedh Asambleja e Përgjithëshme me propozim të Presidentit të KSSH-së.

Presidenca Ekzekutive e KSSH-së, drejton, organizon dhe ndjek veprimtarine për zbatimin e vendimeve të Kongresit dhe të Asamblesë së Përgjithëshme te KSSH-se. Nëpërmjet Presidentit të KSSH vendos për thirrjen e Asamblesë së Përgjithëshme dhe pregatit materialet që i paraqiten asaj.

Presidenca Ekzekutive e KSSH-së, organizon gjithë punën organizative, koordinuese dhe teknike të gjithë strukturave të KSSH-së, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të aktivitetit sindikal. Ajo ndjek planifikimin dhe zbatimin e strategjisë për kualifikimin dhe trajnimin e të gjithë anëtarësisë sindikaliste sipas programeve të caktuara nga Departamenti i Edukimit dhe Qendra e Trajnimit dhe Studimeve Sindikale.

Presidenca Ekzekutive vendos për strukturën ekzekutive të administratës për të gjithë të punësuarit me kohë të plotë në të gjithë strukturat e KSSH-së. Diskuton dhe merr vendime për problemet që lidhen me mireadministrimin e pasurisë, përfshirë objektet dhe mjetet financiare, që posedon Konfederata. Ndjek zbatimin e buxhetit dhe të planeve ekonomike e financiare dhe raporton për to para Asamblesë së Përgjithëshme te KSSH-se.

## **Neni 12**

Presidenca Ekzekutive, me propozim të Presidentit të KSSH-së, miraton numrin dhe emërimin e Koordinatorëve (sekretarëve) Rajonal të Njesive Administrative.

Sekretarët rajonalë janë të punësuar (funktionare) vetëm në rast se ka një vendim të shprehur të Presidenës Ekzekutive të KSSH-së, në të kundert ata janë aktivistë të caktuar për kryerjen e detyrës së Koordinatorit Rajonal pa pagesë, me ose pa shpërblim.

Sekretarët rajonal të njesive administrative janë përgjegjës për funksionimin dhe koordinimin e veprimtarisë sindikale të gjithë strukturave të KSSH-së, në territorin që mbulojnë.

Mbledhjet e Presidencës Ekzekutive në cdo rast thirren dhe drejtohen vetëm nga Presidenti i KSSH-së, përgatiten nga departamentet e KSSH-së. Presidenca Ekzekutive mbledhet si rregull një herë në tre muaj.

Procesverbali i mbledhjes së Presidencës Ekzekutive të KSSH i zbardhur dhe vendimet e saj firmosen, për efekt vlefshmërie, nga Presidenti i KSSH.

### **Neni 13**

#### **PRESIDENTI I KSSH-së**

Presidenti i KSSH-së, është drejtuesi më i lartë në nivelin politik dhe administrativ në KSSH. Ai është përgjegjësi kryesor për drejtimin dhe funksionimin e veprimtarisë së KSSH-së, në zbatim të Statutit, rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Forumet Drejtuese të KSSH-së.

Presidenti i KSSH-së, përfaqëson Konfederatën në veprimtaritë me të tretët, përfshi institucionet shtetërore, partitë politike, organizatat shoqërore, sindikatat e tjera, me punëdhënësit dhe organizatat e punëdhënësve shtetërorë dhe privatë, me median, shoqërinë civile, etj, brenda dhe jashtë vendit.

Presidenti i KSSH-së, drejton dhe bashkërendon punën me Asamblenë dhe Presidencën Ekzekutive të KSSH-së, nënshkruan në emër të KSSH-së marrëveshjet dhe kontratat me Qeverinë, me institucionet të tjera shtetërore politikëbërëse dhe vendimmarrëse, me punëdhënësit dhe organizatat e punëdhënësve, që veprojnë në shkallë kombëtare dhe me cdo të tretë. Ai nënshkruan në emër dhe për llogari të strukturave të KSSH-së, të gjithë dokumentacionin shkresor dhe financiar të KSSH-së, përfshi edhe cdo vendim të strukturave vendimmarrëse statutorë të KSSH-së. Kryen cdo detyrë tjetër të caktuar nga ky statut dhe vendimmarrja e organeve statutorë të KSSH-së.

Presidenti i KSSH-së, miraton për efekt vlefshmërie vendimmarrjet kolegjale të strukturave konfederative rajonale vendore në shkallë të fundit, në të kundërt vendimet e tyre nuk sjellin asnjë pasoje ligjore dhe organizative për KSSH-në.

Presidenti i KSSH-së, mban qëndrim, merr vendime dhe bën deklaratat e prononcime për çështje emergjente që nuk presin dhe vë në dijeni, në mbledhjen më të afërt Presidencën Ekzekutive dhe Asamblenë e Përgjithëshme të KSSH-së. Ai ndjek zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të caktuara nga Presidenca Ekzekutive dhe Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-së.

### **Neni 14**

Presidenti i KSSH-së, në përputhje me Ligjin dhe Statutin e KSSH-së, kryen funksionin e punëdhënësit për punonjësit që punësohen në strukturat e KSSH-së, në qendër dhe në njesitë administrative. Ai në bashkëpunim me strukturat organizative drejton veprimtarinë dhe aktivitetet e përditshme të aparatit të KSSH-së. Ai në konsultim me Presidencën Ekzekutive sipas rastit, vendos për rangun dhe përbërjen e delegacioneve që përfaqësojnë KSSH-në, në veprimtaritë ndërkombëtare si dhe për ftesat që i drejtohen KSSH-së, nga sindikatat simotra. Ai ndjek ecurinë e buxhetit dhe zbatimin e planeve ekonomike e financiare të Konfederatës dhe informon për to Presidencën Ekzekutive të KSSH-së. Presidenti i KSSH-së përfaqëson KSSH-

në në bordet dy apo tre palëshe në nivel qendror në strukturat shtetërore apo jo shtetërore, dhe kryeson bordet që krijohen në Konfederatë në nivel qendror.

### **Neni 15**

Në vendimarrjen e Presidencës Ekzekutive apo të Asamblesë së Përgjithshme në rastet kur mungon konsensusi dhe kur votat në këto struktura ndahen në mënyrë të barabartë, fiton ai variant që ka mbështetjen e Presidentit të KSSH-së. Në mungesë të Presidentit të KSSH-së, këto funksione kryhen nga njëri nga Zv/Presidentët e KSSH ose njëri prej drejtuesve kryesor të KSSH, me prokurë me shkrim nga Presidenti i KSSH-së, apo me Vendim të Presidencës Ekzekutive që merret me 2/3 e anëtarëve të saj. Në rastet kur Presidenti i KSSH-se, lë detyrën për shkak të përligjura, pozicioni i tij nuk mund të vazhdojë pa u zëvendësuar me shumë se 6 muaj. Brenda këtij afati, në përputhje me Statutin, Rregulloren dhe Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, thirret Kongresi i Jashtëzakonshëm, i cili zgjedh Presidentin e ri.

## **KREU I TRETË**

### **Neni 16**

#### **FEDERATAT SINDIKALE DHE ORGANIZATAT QËNDRORE SINDIKALE**

Federatat Sindikale dhe Organizatat Qëndrore Sindikale, anëtare të KSSH-së janë persona juridik. Federatat Sindikale dhe Sindikatat nuk janë organe vendimmarrëse të KSSH-së. Në çdo rast, çdo vendim i Federatës apo sindikatës anëtare të KSSH, i cili nuk është miratuar në mënyrë të shprehur nga strukturat statutorë kombëtare të KSSH-së, nuk sjell asnjë pasojë ligjore apo organizative për KSSH-në.

Statuti i Federatave Sindikale apo i Organizatave Qëndrore Sindikale duhet të jetë i unifikuar dhe harmonizuar me Statutin e KSSH-së, përfshirë parimet, qellimet, dhe funksionimin demokratik të organeve të zgjedhura, të drejtat dhe detyrimet ndaj bashkësisë Konfederative, etj. Antarësimi i Federatave apo i Organizatave Qëndrore Sindikale në Konfederatë, është shprehje e njëkohshme vullnetit të lirë të antarësisë sindikale e pasqyruar nëpërmjet vendimarrjes demokratike të strukturave të tyre dhe shprehje e lirë e organeve statutorë vendimmarrëse të KSSH-së.

Anëtarësimi apo largimi i këtyre nga KSSH-ja, bëhet vetëm në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë Statut.

Asnjë organizatë sindikale Federative apo sindikale, nuk mund të jetë anëtare e KSSH-së pa një vendim të qartë dhe të shprehur të KSSH-së nëpërmjet strukturave të saj statutorë vendimmarrëse kombëtare. Çdo deklaram i njëanshëm i cilësdo Federatë sindikale apo sindikate, qoftë ky i bërë edhe përpara miratimit të këtij statuti, për të qënë anëtare e KSSH në mënyrë të njëanshme, nuk sjell asnjë pasojë për KSSH-në.

Me anëtarësimin në Konfederatë, Federata Sindikale apo Organizata Qëndrore Sindikale ruan pavarësinë dhe identitetin e saj për sa i përket aktivitetit dhe politikave të saj sindikale sektoriale dhe respekton identitetin dhe pavarësinë e Federatave apo Organizatave Sindikale Qëndrore të tjera, veç e veç dhe të Konfederatës në tërësi.

Largimi i Federatës apo Sindikatës nga KSSH nuk sjell asnjë pasojë dhe nuk ka asnjë efekt ndaj KSSH-së në cfardolloj drejtimi.

Për çështjet më thelbësore sindikale, siç janë parimet e ndërtimit të Konfederatës, struktura organizative e saj, përcaktimi i politikave për levizjen sindikale në tërësi, zgjedhja e organeve drejtuese në të gjitha nivelet e KSSH-së, kuotizacioni dhe mënyra e administrimit dhe përfitimit të të ardhurave që disponon Konfederata, behet përpjekje për arritje të konsensusit. Në mungesë të arritjes së konsensusit vendimarrja merret me votim të cilësuar sipas rastit në Kongres, Presidencën Ekzekutive apo Asamblenë e Përgjithshme të KSSH-së.

Një Bashkësi Organizatash Sindikale, Këshillash dhe Seksionesh Sindikale të një dege ose profesioni, në kuptimin e këtij Statuti, gëzon statusin e Federatës sindikale kur bashkon në strukturat e veta jo më pak se 2000 anëtarë me kuotizacion, kur ka të anëtarësuar 10-15 përqind të punësuar të degës ose profesionit dhe kur ka një shpërndarje gjeografike në jo më pak se 50 përqind të njësive administrative vendore sipas ndarjes administrative në shkallë kombëtare.

Bashkesitë e Këshillave dhe Seksioneve Sindikale që nuk plotësojnë kushtet për të fituar statusin e një Federate, konsiderohen Sindikata Qendrore të deges së ekonomisë dhe profesionit. Ato bashkohen me Organizatat Sindikale të profesionit apo Federatat Sindikale me profesion të ngjashëm në KSSH, ose anëtarësohen drejtperdrejt në KSSH, me kusht që në KSSH të mos ketë Federatë të kësaj dege dhe profesioni. Këto vendime merren në Asamblenë e Përgjithshme të KSSH-së, duke respektuar Statutin e KSSH-së.

Pranimi i një Federate apo Organizate Qendrore Sindikale konsiderohet i kryer plotësisht vetëm pas deklarimit të vullnetit të organeve statutores të KSSH në këtë drejtim nëpërmjet një vendimi të dokumentuar.

## **KREU I KATËRT**

### **Neni 17**

#### **ASAMBLEJA SINDIKALE VENDORE**

Pranë çdo njësie administrative vendore, në përputhje me Statutin e KSSH-së, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së, ngrihen dhe funksionojnë Asambletë sindikale vendore. Këto asamble përbëhen nga përfaqësues të zgjedhur nga Seksionet Sindikale të Federatave apo Organizatave Qendrore të Profesionit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda njësisë administrative të caktuar si dhe nga Sekretari rajonal i KSSH si dhe kordinatorët rajonal të KSSH-së për rininë, gruan dhe pensionistët. Përpara se të konsiderohet anëtar i Asamblesë sindikale vendore, përfaqësuesi i zgjedhur i seksionit sindikal duhet të miratohet nominalisht nga Presidenca Ekzekutive e KSSH.

Asambleja sindikale vendore udhëhiqet dhe drejtohet nga Sekretari Rajonal i KSSH në zbatim të vendimeve të Presidencës Ekzekutive. Asambleja sindikale vendore mbledhet jo më pak se një herë në 3 muaj.

Asambleja sindikale vendore funksionon në përputhje me ndarjen administrative teritoriale. Ajo shqyrton dhe vendos për problemet më të rëndësishme të lëvizjes sindikale në këto njësi vendore, bashkerendon punën e Seksioneve Sindikale brenda njësisë së saj dhe i mbështet ato. Ajo ndjek me përparësi punën për zbatimin e vendimeve dhe rezolutave të strukturave më të larta Konfederative. Këto Asamble vendore janë organi i vetëm që bejnë analizen dhe vlerësimin e veprimtarisë sindikale në territorin e tyre. Ajo zgjedh përfaqësuesit e saj sipas statutit të KSSH-së në të gjithë strukturat drejtuese të KSSH-së.

Asambleja sindikale vendore ngrihet kur në përbërje të saj funksionojnë jo më pak se 4 Seksione sindikale që përfaqësojnë jo më pak se 400 anëtarë me kuotizacion të plotë. Në ato raste kur në një njësi vendore nuk plotësohen kushtet statutore për ngritjen e asamblesë vendore, seksionet sindikale që funksionojnë në këtë njësi lidhen drejtperdrejtë me KSSH ose me njësinë vendore më të afërt sipas vendimit të Presidences ekzekutive të KSSH-së.

Asambleja sindikale vendore kur e gjykon të arsyeshme dhe të nevojshme mund të organizojë takime, tryeza ose konferenca, ballafaqime, ndërmjetesime etj. për të diskutuar probleme të lëvizjes sindikale në territorin ku ushtron aktivitet ose më gjerë. Asambleja vendore propozon organizimin e grevave, protestave, tubimeve sipas ligjit dhe statutit të KSSH-së brenda teritorit që ushtron aktivitetin.

Asambleja sindikale vendore ndjek në menyre operative mbarëvajtjen, organizimin dhe funksionimin e gjithë lëvizjes sindikale, si kontraktimi kolektiv, kuaotat e anëtarësisë, trainimin sindikal dhe rekrutimin e anëtarëve të rinj në të gjithë territorin e qarkut.

Sekretari rajonal i KSSH-së dhe drejtuesi i seksionit sindikal përkatës, kanë detyrë funksionale ndjekjen e kontraktimit kolektiv dhe grumbullimin e administrimin e kuotave të anëtarësisë në përputhje me statutin dhe rregulloret e KSSH-së.

## **Neni 18 SEKSIONI SINDIKAL**

Seksion Sindikal i Degës ose Profesionit përkatës konsiderohet ajo strukture, e cila përfshin jo më pak se 3 organizata sindikale të bazës me jo më pak se 15 anëtar secili, ose edhe një bashkësi të vetme sindikale në rang ndërmartjeje, kompanie apo institucioni. Në të dy rastet seksioni duhet të ketë jo më pak se 50 anëtarë me kuotizacion.

## **Neni 19**

### **RRJETI I GRAVE, RRJETI I TË RINJËVE DHE RRJETI I PENSIONISTËVE**

Pranë KSSH-së funksionojnë Rrjeti i Grave, Rrjeti i të Rinjëve dhe Rrjeti i Pensionistëve. Këto Rrjete janë me karakter konsultativ dhe përfaqësojnë interesat e grave, të rinjve dhe pensionistëve si grupe interesi specifike në fushat ekonomike, sociale, profesionale, kulturore, shëndetësore, sportive, arsimore, edukative, të punësimit, të shpërblimit, etj. Në të gjithë

strukturat drejtuese të KSSH-së, që nga niveli i bazës deri në piramidë 30% e të zgjedhurve duhet të jenë gra dhe po 30% e të zgjedhurve duhet të jenë të rinj (deri 34 vjeç).

Këto rrjete funksionojnë me Rregullore përkatëse të miratuara nga Asambleja e KSSH-së, në përputhje me këtë Statut.

## **KREU I PESTË**

### **Neni 20**

#### **KOMISIONI I STATUTIT DHE GJYKIMIT DISIPLINOR**

Për të interpretuar dhe zbatuar drejt Statutin, për të zgjidhur në mënyrë demokratike mosmarrëveshjet në përputhje me statutin e KSSH-së dhe ligjshmërinë dhe legjislacionin shqiptar dhe për të edukuar anëtarët me frymën e respektimit të statudit, rregulloren apo vendimet e tjera të miratuara nga strukturat vendim marrëse të KSSH-së, ushtron aktivitetin e tij Komisioni i Statutit dhe Gjykimit disiplinor. Ai perbëhet sipas strukturës së vendosur në kongres. Çdo anëtar i këtij komisioni duhet të ketë vjetërsi në sindikatë mbi 3 vjet. Mundësisht të jenë ekspert dhe me reputacion të lartë në sindikatë.

Ky komision kryen studime dhe konsultime për përmirësimet e nevojshme në Statut dhe i nxjerr rekomandime e propozime strukturave vendim marrëse të KSSH-së. Ai vendos mbi konfliktet që i perkasin interpretimit të Statutit. Kontrollon direktivat dhe vendimet e strukturave për përputhshmërinë me statutin.

Komisioni i Statutit dhe Gjykimit disiplinor ushtron kontroll në të gjitha forumet dhe strukturat e KSSH-së, në të gjitha nivelet për zgjidhjen e kërkesave e ankesave të anëtarëve dhe zbatueshmërinë e plotë statutore.

Çdo anetar i këtij Komisioni nuk duhet të ketë lidhje direkte me analizat e gjykimit në fjalë si individ, apo sindikatën që përfaqëson. Në këtë rast anëtari që ka lidhje direkte me individin apo sindikatën që diskutohet apo gjykohet, nuk merr pjesë në diskutim dhe vendimarrje.

Me propozim të Presidentit të KSSH, njërin nga anëtarët e tij ky komision e zgjedh kryetar të këtij komisioni.

Komisioni raporton në çdo vit në Presidencën Ekzekutive të KSSH-së ndërsa në Kongres raporton për aktivitetin e gjithë mandatit të tij. Anëtarët e komisionit japin llogari para anëtarëve të sindikatës dhe forumeve që i ka zgjedhur.

Komisioni i statudit dhe gjykimit disiplinor vendimet i merr me shkrim dhe ua paraqet palëve të interesuara dhe Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së, e cila në mbledhjen e radhës diskuton dhe vendos për to. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së, është i formës së prerë. Megjithatë, i fajësuar ka të drejtë t'i drejtohet Kongresit, vendimi i të cilit është përfundimtar. Strukturën e komisionin e statudit dhe gjykimit disiplinor e zgjedh Kongresi i rregullt i KSSH-së.

## **Neni 21**

### **KOMISIONI I FINANCËS DHE AUDITIMIT**

Komisioni i Financës dhe Auditimit, ndjek dhe kontrollon problemet financiare në të gjithë strukturat e KSSH-së. Ky Komision, me Propozim të Presidentit të KSSH-së zgjedh Kryetarin. Komisioni i Financës dhe Auditimit të KSSH-së është i detyruar të revizionojë dhe çertifikoje vetë ose me ekspert llogaritë dhe bilancet vjetore të KSSH-së.

Komisioni i Financës dhe Auditimit ka për detyrë që në vijueshmëri të kontrollojë zbatimin e buxhetit, përdorimin e drejtë dhe në përputhje me Statutin e Legjislacionin në fuqi të mjeteve financiare e monetare, mirëmenaxhimin e pasurisë së Sindikatës. Ky Komision bashkëpunon me Komisionet përkatëse të Federatave dhe me Presidencën Ekzekutive të KSSH-së, duke shkëmbyer informacione dhe duke dhënë rekomandime, e marrë vendime, në zbatim të Statutit, Rregulloreve e Vendimeve të Strukturave Vendimmarrëse të KSSH-së.

E gjithë veprimtaria e këtij Komisioni mbahet e dokumentuar me shkrim, mbledhjet dhe vendimet e tij, pasqyrohen me proces-verbal me shkrim, ku një kopje dërgohet në Presidencën Ekzekutive të KSSH-së. Ky Komision raporton një herë në vit në Asamblenë e Përgjithshme dhe në Kongresin e radhës raporton për aktivitetin e tij gjatë gjithë mandatit. Anëtarët e këtij Komisioni japin llogari përpara strukturave vendimmarrëse të KSSH-së dhe janë të revokueshëm nga forumi që i ka zgjedhur.

## **Neni 22**

### **MENAXHIMI I AKTIVITETIT EKONOMIK DHE SINDIKAL**

Me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme të KSSH-së për të ndihmuar lëvizjen sindikaliste dhe për të rritur transparencën në menaxhimin e asetëve ekonomike të KSSH-së pranë KSSH-së mund të krijojet një qendër ekonomike e cila menaxhon dhe administron të gjitha resurset ekonomike të KSSH-së dhe sindikatave dhe e ndan administrativisht aktivitetin e lëvizjes sindikale me aktivitetin ekonomik të sindikatës. Nëse Asambleja e Përgjithshme e KSSH vendos, kjo Qendër në aktivitetin e saj do të jetë e pavarur nga KSSH dhe levizja sindikale.

### **KREU I GJASHTË**

## **Neni 23**

### **BURIMET FINANCIARE TË KSSH-së**

KSSH siguron të ardhurat e saj financiare nga pjesa e kontributit që derdh çdo Federatë ose Sindikatë nga kuotat e antarësisë, nga vënia në shfrytëzim e përdorimi në përputhje me ligjin i



pasurisë dhe objekteve ekonomike që gëzon me ligj Konfederata, nga projekte, donacione, dhurata dhe cdo e ardhur tjetër që sigurohet në mënyrë të ligjshme.

Të ardhurat financiare të KSSH-së administrohen vetëm sipas vendimarrjes së organeve statutore kombëtare vendimarrëse të KSSH që janë Kongresi, Asambleja e Përgjithshme, Presidenca Ekzekutive dhe Presidenti i KSSH-së. Asnjë organ tjetër i Federatave anëtare të KSSH-së apo strukturave të tjera organizative të KSSH nuk sjell asnjë pasojë për KSSH-në pa miratimin e shprehur dhe të dokumentuar të organeve statutore të KSSH të përmendura më sipër.

Kuota e anetarësise për çdo Federatë, apo Organizatë Qëndrore Sindikale, anëtare të KSSH-së, vendoset nga strukturat e tyre vendimarrëse. Ajo nuk mund të jetë më pak se 05 % dhe më shumë se 1% e pagës mujore neto për çdo anëtar. Perjashtim bëjnë pensionistët, të cilët paguajnë jo më pak se 10 lekë në muaj pranë sindikatave/rrjeteve të tyre të profesionit apo territorit.

Të ardhurat nga kuotizacioni mbledhen si rregull i përgjithshëm në rrugë bankare, me numër llogarie në bankë sipas vendimarrjes së Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së dhe pastaj në përputhje me statutin, rregulloren financiare dhe vendimet e Asamblesë së KSSH shkojnë në destinacionin e perdorimit të tyre. Ndarja e kuotizacionit sindikal, përveç kur Asambleja e KSSH-së vendos ndryshe, do të jetë si më poshtë:

1. **20% të kuotave seksionit sindikal të degës/profesionit**
2. **20 % të kuotave Asamblesë vendore të KSSH ose strukturës vendore të KSSH-së**
3. **40 % Federata Sindikale e Profesionit**
4. **20 % KSSH**

Mos pagesa me 3 muaj rresht e çdo anëtar të kuotës sindikale, e pushon qënien e tij si anëtar sindikate.

Pronari i mjeteve monetare dhe i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme që KSSH-ja, ka trashëguar ose fituar me ligj dhe me çdo formë tjetër që njeh ligji i Republikës së Shqipërisë, është vetëm KSSH. Asambleja e përgjithëshme, Presidenca Ekzekutive e KSSH-se është administratori dhe menaxhuesi i kësaj pasurie.

Federatat sindikale apo sindikatat anëtare të KSSH nuk kanë asnjë lidhje me të ardhura apo burime të tjera të ardhurash të KSSH-së, të fituara sipas ligjit (pasuri, donacione, etj), përveç kuotizacionit sindikal që ndahet vetëm sipas percaktimeve të bëra në këtë statut.

Me propozim të Presidencës Ekzekutive të KSSH-së, Asambleja e Përgjithshme e Konfederatës, miraton Rregulloren për administrimin dhe menaxhimin e përditshëm të pasurisë dhe të ardhurave.

## **KREU I SHTATË**

### **Neni 24**

#### **MOSPRANIMI DHE PACËNUESHMËRIA E ZGJEDHJEVE**

Zgjedhjet mund të kundërshtohen brenda 10 ditëve nga data e kryerjes së tyre. Deklarimi i mospranimit të tyre duhet të bëhet me shkrim duke treguar qartë dhe argumentuar arsyet e kundërshtimit. Të autorizuar për të kundërshtuar një zgjedhje apo mbledhje janë: 1/3 e njerëzve të lejuar për të votuar në zgjedhjen që është kundërshtuar. I deleguari për të ndjekur zgjedhjen ose anëtar i Asamblesë së Përgjithshme të njësisë qendrore, i cili është i mandatuara nga rajoni ku kryhet zgjedhja.

Mospranimi i një zgjedhje duhet të lejohet nëse një e metë që është konstatuar ka ndikuar direkt në rezultatin e zgjedhjes. Organi më i lartë statutor për kontrollin e ligjshmërisë brenda 10 ditëve merr vendimin dhe kthen përgjigje me shkrim të ankesave për vlefshmerinë e zgjedhjeve.

Në rast se një organizatë sindikale, Asamble vendore, sindikatë profesioni apo federate sindikale ka zhvilluar një veprimtari të kontestueshme (nga zgjedhja deri tek kuotacioni) të papranueshme nga statuti apo rregulloret e miratuara të KSSH, Asambleja e KSSH merr vendime për anulimin dhe vendos për të kryer deri në rizgjedhje apo riorganizim të kësaj strukture kur ka pasoja në lëvizjen sindikale.

## **KREU I TETË**

### **Neni 25**

#### **DISPOZITA TË VEÇANTA**

Në të gjithë strukturat e KSSH-së, Konfederative, Federative, Profesionale, Rajonale e Vendore, Organet drejtuese zgjidhen në mënyrë demokratike nga poshtë lart, japin llogari para zgjedhësve dhe janë të revokueshëm prej tyre në cdo kohë, përveç kur në këtë statut përcaktohet shprehimisht ndryshe.

Mandati i lidërshiptit sindikal në cdo nivel është i papajtueshem vetëm me funksionin e drejtuesit të Partive Politike dhe me funksionet e punëdhënësit.

Mandati i lidërshiptit sindikal Politik është i papajtueshëm (humbet e drejta për ta fituar) kur gjysma e parë e këtij mandati korrespondon me afatin ligjor të mbushjes së moshës për pension. Ky mandat për strukturat vendore sindikale është i papajtueshëm kur përfituesi i mandatit nuk është me vendbanim ligjor të përhershëm apo me punë të përhershme në territorin, njësinë administrative apo ndërmarrjen që e mandaton.

Të zgjedhurit për të përfituar mandat në nivel qendror (Vendin e Presidentit të KSSH-së, Sekretarit të përgjithshëm të Federatës) duhet të jenë anëtar të organizmave drejtuesë të Konfederatës, Federatave ose Asambleve vendore. Qënia e tyre delegat në strukturën që i zgjedh dhe pranimi me vullnet të lirë të kandidimit janë të domosdoshme.

KSSH ka Statutin, programin, flamurin, emblemën dhe vulën e saj që janë me tre ngjyra; të kuqe, të zezë dhe jeshile. Federatat apo organizatat qendrore sindikale anëtare të KSSH-së, kanë edhe ato flamurin, emblemën dhe vulën e tyre, si dhe Statutin dhe programin e tyre të unifikuar dhe

integruar në frymën e Statutit dhe programit të KSSH-së. Në stemën e cdo federate apo organizate sindikale është e shënuar sigla e KSSH-së me ngjyrë jeshile.

Të drejtën e përdorimit të simboleve të KSSH-së, e kanë vetëm institucionet që perfaqësojnë KSSH-në, në nivel qëndror e vendor.

#### **Neni 26**

### **VEPRIMTARIA BOTUESE**

KSSH mund të botojë organin e saj periodik të shtypit, që është Gazeta “Pasqyra”. Me vendim të Presidencës Ekzekutive mund të botohen edhe organe të tjera shtypi, buletine, panflete, pankarta, reklama, faqe sociale, etj; në shtypin e përditshëm, apo në mediat audio vizive. KSSH ka faqen e saj të website-it sipas vendimarrjes përkatëse.

#### **Neni 27**

### **SHPËRNDARJA**

KSSH-ja pushon së ekzistuari në bazë të kriterëve që përcakton ligji (kodi i punës) dhe sipas mënyrës që përcakton ky statut.

#### **Neni 28**

Statuti ka marrë fuqi ligjore për t’u zbatuar nga data 30 Nëntor 2014, miratuar në Kongresin e Pestë të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë.

**Tiranë, më 30 Nëntor 2014**